



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:071938

Datë: 23.12.2020

Numri i dokumentit: 01367355

**P.nr.1067/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P, gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit R. B.sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II.nr 2726/18 të dt.26.12.2018, për shkak të dy veprave penale të vjedhjes s nga neni 325 par1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit R. B. dhe të prokurorit të shtetit Sadije Muriqi me dt.23.12.2020 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri R. B.i lindur me dt..... në .... , tani me vendbanim në fsh. .... Komuna e ...., i biri i F. dhe nënës A. e gjinisë M., i njohur me dokument identifikues numër ....., ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor krahu, i i pa martuar ,i gjendjes së mesme ekonomike, kinse i pa dënuar më parë nga gjykata, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , më parë i pa dënuar, gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

I.Me dt. 24.9.2018, rreth orës 19:00 në .... , në rrugën ..... , pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit I. K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore , merr pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarit ,në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari i len dy palë patika të firmës ..... në hyrje të shtëpisë , aty shkon pandehuri i cili i merr patikat , e më pas largohet nga vendi i ngjarjes pa u vërejtur nga askush. .

-me çka ka kryer veprë penale : vjedhje nga neni 325 par 1 të KPRK-së

II. me dt. 24.9.2018, rreth orës 19:00 në Pejë , në rrugën ..... , pikërisht në shtëpinë e të dëmtuarit I. K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore , merr pasurinë e luajtshme pronë e të dëmtuarit ,në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari i len katër palë patika të firmës .... në hyrje të shtëpisë , i pandehuri hap derën e shtëpisë , ku nga hyrja merr patikat e të dëmtuarit , e gjersa i pandehuri largohet nga vendi i ngjarjes , i njëjti vërehet nga dëshmitari G. K., i cili e vëren të pandehurin duke u larguar me një qese të kuqe në dorë

-me çka ka kryer veprë penale : vjedhje nga neni 325 par 1 të KPRK-së

Prandaj gjykata të pandehurin konform nenit 41, 42,43,46 ,49 ,50,51,52, 76 dhe nenit 325 par 1 të KPRK-së, të pandehurin.

**E GJYKON :**

### **Për veprën e parë:**

1. Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Dhe :

### **Me dënim burgu,**

2. Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

### **Për veprën e dytë**

- 1 Me dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro , e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Dhe :

### **Me dënim burgu,**

- 2 Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

Gjyqtari konform nenit 80 par 1 të KPRK-së të pandehurit i shqipton :

### **DËNIMIN UNIK**

Në atë mënyrë që të pandehurit për të dy veprat penale ia përcakton dënimin unik me të holla në shumë prej 400 euro e të cilën gjobë i pandehuri fare nuk do ta paguaj nëse në afat prej 1( një )viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Dënimin me burg në kohëzgjatje prej 8 muajsh , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 2 vitesh nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale

I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i shpenzimeve të procedurës penale.

I dëmtuari për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.26.12.2018 kundër të pandehurit R. B. ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.2726/18, për shkak të dy veprave penale vjedhje nga neni 325 par 1 të KPRK-së , duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e singertë të fajësisë- që është rrethanë veçanërisht lehtësuese , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, faktin se i pandehuri jeton i vetëm në një shtëpi të kushërinjve dhe jeton nga puna e tij fizike-ndonëse shumë rrallë gjen punë dhe nga ndihma e familjarëve, dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform neni 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform neni 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform neni 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.23.12.2020

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

#### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .